

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Fatime Dermaku, me zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, procesmbajtëse, në çështjen penale, kundër të pandehurit M. K., nga fshati K., KK O., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1325/14 të datës 05.05.2016, të cilën e përfaqësonte prokurorja e Shtetit Nebahate Salihu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 22.02.2018, mori dhe publikisht shpalli në njëjtën ditë këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri M. K., nga babai B. dhe nëna N., e lindur Z., i lindur më *data e lindjes...*, në P., tani me vendbanim në fshatin K., KK O., me numër personal *numri personal...*, me nr. Tel. *Numri i telefonit...*, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i p[unësuar, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se:

Prej datës së pacaktuar e deri me datën 06.06.2013, në shtëpinë e tij, e cila gjendet ne O., lagjja “Q.”, me qëllim që vetit t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që është kyçur direkt në rrjetin elektrik pa njëhsor elektrik, me qëllim të shmangies së pagesës të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç’rast të dëmtuarës KEDS, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 496, 94€,

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtarja e vetme gjykuese, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 51,52, 73,74,75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 248 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit M. K., i shqipton :

GJYKIM ME KUSHT- ME BURGIM DHE ME GJOBË

- Ashtu që të pandehurit M. K., i caktohet dënimi me burg kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 €, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë/paguajë, nëse në afat prej 1(një) viti, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

- Nëse revokohet dënime me gjobë dhe i pandehuri, nuk mundet apo nuk do t'a përmbush atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim edhe atë për 20 €, të dënimit me gjobë do të vuaj një ditë burg.
- E dëmtuara KEDS për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil
- I pandehuri obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë 20 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 05.05.2016, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1325/14, ndaj të pandehurit M. K. nga fshati K. KK O., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Pas pranimit të aktakuzës, gjyqtarja e vetme gjykuese, e ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 22.02.2018, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka konstatuar se i pandehuri, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga a pandehura, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri M. K., me dashje e ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 320 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të Vjedhje e shërbimeve komunale e kryen “Kushdo që merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, gjyqtarja e vetme gjykuese, e ka shpallur fajtor të pandehurën M. K., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, ngase në veprimet e të njejtit konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë, i njëjti, nga data e pacaktuar e deri me datën 06.06.2013, në shtëpinë e tij, me qëllim që vetit t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që është kyçur direkt në rrjetin elektrik pa njëhsor elektrik, me qëllim të shmangies së pagesës të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç’rast të dëmtuarës KEDS, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 496, 94€.

5. Vendimi për shpalljen fajtores

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka vendosur që të pandehurin M. K., t’a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur meqenëse u vërtetua se I njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njejtën është përgjegjës.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurës, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë sjelljet e mira të tij gjatë shqyrtimit fillestar; pranimin e fajësisë; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës gjyqtarja e vetme gjykuese, ja fali besimin, i njëjti është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj tij, nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, poashtu Prokurori i Shtetit i ka propozuar Gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, dhe t’a merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, nëse i pandehuri, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 200€, të cilën nuk do t’a paguaj nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale, Nëse revokohet dënime me gjobë dhe i pandehuri nuk mundet apo nuk do t’a përmbush atëherë dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim edhe atë për 20 €, të dënimit me gjobë do të vuaj një ditë burg, Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit dhe të ardhurat e tij, meqenëse siç e theksuam më lartë është i gjendje së dobët ekonomike, baba i katër fëmijëve, ndërsa, gjyqtarja e vetme gjykuese, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 200€, të cilën i pandehuri, nuk do t'a paguaj nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale, Nëse revokohet dënime me gjobë dhe i pandehuri nuk mundet apo nuk do t'a përmbush atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim edhe atë për 20 €, të dënimit me gjobë do të vuaj një ditë burg ndaj të pandehurit M. K., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit, nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Udhëzimi I të dëmtuarës në kontest juridiko-civil

Gjykata konform nenit 458 e 463 të KPPRK-se vendosi që të udhëzoi të dëmtuarën në kontest civil.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese, duke u bazuar nënin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2149/16, më 22.02.2018

Zyrtarja ligjore,
Edona Grajçevci

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Fatime Dërmaku

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.